



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Kërkim Shkencor

Ngarkesa: 6 Kredite - (= 60 orë mësimore); Leksione: 3 Kredite - (= 30 orë mësimore);
Seminare: 3 Kredite - (= 30 orë mësimore);
Viti / Semestri : Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave, Përkthim Teknik-letrar dhe Interpretim
Kodi i etikës: Kodi i etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të prezantojë studentët me fushat kryesore të kërkimit në Studimet Përkthimore. T'i aftësojë studentët për të planifikuar dhe realizuar në mënyrë të pavarur kërkime akademike në përkthim. Të nxisë reflektimin kritik mbi temat, sfidat dhe qasjet metodologjike të kërkimit në këtë disiplinë.

Objektivat specifike lëndore:

1. T'u mësojë studentëve të dallojnë qartë kërkimin konceptual nga ai empirik në përkthim.
2. T'i pajisë studentët me teknika për përgatitjen dhe shkrimin e eseve kërkimore, kumtesave dhe mikrotezave.
3. Të zhvillojë aftësitë për hartimin e platformës kërkimore dhe përzgjedhjen e metodave të përshtatshme.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë të:

1. Identifikojnë metodat kryesore të kërkimit shkencor, të përshtatshme për Studimet Përkthimore;
2. Zgjedhin dhe diskutojnë metodat më të përshtatshme për projektin kërkimor-shkencor;
3. Shpjegojnë teorinë e zbatuar në modelet krahasimore, të procesit dhe ato shkakësore në Studimet Përkthimore;